



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 22.01.2026

**MBLEDHJA Nr. 03,
Datë 26 .01.2026, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 26.01.2026, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 03 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE, për transferimin e aseteve fikse të saj.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL sh.p.k ” për licensim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike .
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “FAVINA 1 sh.p.k” për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “RENEW”sh.p.k për dhënien e e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
5. Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.179, datë.08.11.2017 “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “ ALBGAS sh.a “, i ndryshuar .
6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**